

Afrim KRASNIQI

**SHQIPËRIA DHE KOSOVA NË VITET 1998-1999: KRIZA
DHE LUFTA, “LEARNING BY DOING”**

Abstrakt:

Në vitin 1997-1998 Shqipëria kaloi një prej krizave më të mëdha shtetërore e shoqërore të periudhës postkomuniste, por edhe u përball me impaktin e shumëfishtë të ndikimeve të ngjarjeve në Kosovë. Kriza e refugjatëve, rezistenca e armatosur dhe diplomacia e bisedimeve, rënia e barrierave të mosnjohjes dhe përpjekja për rol kujdestar, përfshirja shpesh aktive dhe tendenca e sjelljes “politikisht korrekt” në raport me këshillat perëndimore, korrektimi i vazhdueshëm i qëndrimeve partiake e shtetërore dhe Kosova si test lidhësi ishin disa prej ngjarjeve dhe tipareve që shoqëruan riformatimin e rolit dhe qëndrimin të Shqipërisë ndaj zhvillimeve në Kosovë në prag të çlirimit të saj më 1999. Në aspektin studimor roli i Shqipërisë merr vlerë referuese dhe shfaq interes për të parë në formë krahasuese përgjegjësitë e ndikimit e shtetit kombëtar, bilancin zyrtar të ndikimit dhe sidomos për të reflektuar mbi legjitimitetin, mekanizmat, si dhe cilësinë dhe natyrën e ndikimit. Përmes burimeve arkivore e dokumentare, si dhe të dhënave të mbledhura nga pyetësorë me ekspertë të fushës dhe periudhës, krijohet mundësia për analizë të thelluar, vlerësim hipotezash dhe kontribut në plotësimin e vakumit ende të dukshëm shkencor në trajtimin e dukurive dhe raporteve të tilla midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Fjalët kyçe: *Shqipëria, Kosova, Kushtetuta, lufta, kriza.*

Në nëntor 1998 Shqipëria miratoi Kushtetutën e parë pas përmbyesjes së sistemit komunist. Kushtetuta e re në Nenin 8 sanksionon përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mbrojtur të drejtat

kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj. Parimi i shtrirjes së përgjegjesisë jashtë territorit shtetëror, në forma thuajse të ngjashme, gjendet në kushtetutat e shumicës së vendeve evropiane. Kushtetuta e RSH-së në preambulë ka vendosur edhe deklarin “*me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar*”, i cili nuk është universal dhe ka shpjegim kryesisht në kontekstin e historisë së shtetformimeve edhe në Evropën Juglindore. Autorët e Kushtetutës nuk mund ta kishin parashikuar se parimi i përgjegjesisë dhe deklarimi mbi aspiratat do të viheshin në sprovë brenda pak muajsh nga miratimi i saj. Gjatë vitit 1998 dhe sidomos në vitin 1999 Shqipëria ishte një nga shtetet më të përfshira në krizën e re të Jugosllavisë, konfliktin dhe më pas luftën në Kosovë.

Në kontekstin e rolit të Shqipërisë në ngjarjet që lidhen me luftën në Kosovë vëmendjen kryesore të botimeve, referimeve dhe përkujtimeve e kanë marrë kryesisht tre elementë: strehimi i një mase jashtëzakonisht të lartë refugjatësh të dëbuar nga Kosova, mbështetja shtetërore dhe politike për luftën, si dhe raportet e Tiranës politike me individë e grupe politike në Kosovë. Tri aspektet janë të rëndësishme, por të pamjaftueshme për të kuptuar të gjithë kontekstin, mundësitë dhe rezultatet. Bazuar në përcaktimin kushtetues dhe pritshmëritë në ushtrimin e përgjegjësive të qeverisjes, analiza e rolit të shtetit shqiptar në ngjarjet e vitit 1998-1999, sidomos në periudhën e luftës, do të duhet t’i jap përgjigje pyetjes kërkimore “*A arriti Shqipëria të përmbushë detyrën e saj kushtetuese dhe rolin e shtetit amë ndaj Kosovës në dy vjetët më historike të saj?* Për të shtjelluar studimin i duhet dhënë përgjigje edhe disa nënpyetjeve të tjera plotësuese të kontekstit. *A kishte Shqipëria kapacitete ekonomike, ushtarake dhe njerëzore dhe a ishte e përgatitur për situatën humanitare, rezistencën dhe luftën në Kosovë? A kishin strategji bashkëpunimi paraprake strukturat shtetërore në Tiranë dhe ato paralele në Prishtinë? A kemi të bëjmë me Shqipërinë si një shtet tjetër aleat me NATO-n apo një shtet me rol aktiv në zgjidhjen e krizës dhe fundin e luftës? A pati përputhshmëri midis qëndrimeve dhe prioritetëve të rezistencës*

paqësore dhe ushtarake në Kosovë dhe të Tiranës zyrtare? Cilat ishin mësimet që nxori Shqipëria nga lufta e Kosovës dhe anasjelltas?

Analiza e thelluar bazohet kryesisht në dokumentet arkivore shqiptare dhe të disa vendeve të tjera, ndër të cilat fondi i Këshillit të Ministrave 1998-1999 shfrytëzohet për herë të parë. Fonde të MPJ-së, të Kuvendit të RSH-së dhe të disa institucioneve vendore janë plotësuese kryesisht për shkak se epiqendra e ushtrimit të pushtetit dhe vendimmarrjes në ato vite ishte Këshilli i Ministrave. Kushtetuta e vitit 1998 e dobësoi rolin e presidentit të Republikës duke forcuar institucionin e kryeministrit, ndërkohë që duke qenë një vend ku partia dominuese dhe qeveria njësoheshin burimi i vendimmarrjes mbetej i njëjtë.

Ndikimi i ndryshimeve politike në performancën shtetërore

Referuar parimit kushtetues Kosova është pjesë e kombit, pjesë e identitetit dhe për rrjedhojë, pjesë e përgjegjësisë shtetërore. Përgjegjësitë e plota kushtetuese nënkuptojnë rolin e shtetit kur ai është në gjendje dhe ka burimet, mundësitë dhe lirinë për të ushtruar funksionet e veta. Kur shteti nuk i zotëron këto kapacitete dhe burime, aftësitë e tij dobësohen edhe përballë përgjegjësive kushtetuese. Shqipëria e vitit 1997-1999 ishte rast i tillë. Ajo përfaqësonte një shtet në post krizë politike, ekonomike dhe sociale me kapacitete të kufizuara për të parandaluar dhe menaxhuar kriza të jashtme. Zgjedhjet e jashtëzakonshme të qershorit 1997, miratimi i Kushtetutës (1998) dhe deri te kapërcimi i fazës emergjente (1998-1999) rotacioni politik u shoqërua me mungesë stabiliteti, ndryshimin e të gjithë strukturës shtetërore në nivel qendror dhe lokal, por edhe ndryshime të shpeshta në linjat dhe prioritetet e politikës së brendshme e të jashtme.

Gjatë të njëjtës periudhë 48-mujore u ndërruan katër qeveri: qeveria Meksi (deri në mars 1997), qeveria Fino (mars-korrik 1997), qeveria Nano (korrik 1997-tetor 1998), qeveria Majko (tetor 1998-tetor 1999), kjo e fundit e pasuar nga një e pestë në nëntor 1999. Bashkë me to, në të njëjtën periudhë u ndryshuan edhe 7 ministra të

Brendshëm dhe 4 ministra të Mbrojtjes.¹ Gjatë të njëjtës periudhë u ndryshua presidenti i Republikës, të gjithë anëtarët e Këshillit të Sigurimit Kombëtar, si dhe u ndryshuan edhe linja drejtuese e operacionale e Shërbimit Sekret (SHISH) dhe Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, sistemi i gjykatave dhe prokurorisë dhe institucioneve ekzekutive.

Në fundin e vitit 1998 asnjë prej drejtuesve të shtetit të vitit 1996 nuk ishin më në detyrë, ndërkohë që midis viteve 1997-1999 rivalitetet brenda mazhorancës së re çuan në ndryshime periodike edhe të drejtuesve të rinj të zgjedhur prej tyre. Ndryshimet e shumta të qeverive, në strukturën drejtuese shtetërore dhe në organet e sigurisë patën impakt të shumëfishtë. Kur Shqipëria u përball me valën e parë të refugjatëve më 1998 nuk kishte asnjë zyrtar me përvojë në administrim të situatave të tilla, strukturat shtetërore u bënë të brishta, bashkë me qeveritë dhe ministrat ndryshuan edhe stafet e tyre politike dhe administrative, si dhe bojkoti politik dobësoi edhe Parlamentin. Në shkurt 1999 deputeti Jonuz Begaj, i cili ishte kryetar i Komisionit Parlamentar Ad-Hoc për mbikëqyrjen e zbatimit të programit për plotësimin e nevojave të refugjatëve nga Kosova, deklaroi në Kuvend se *“me gjithë angazhimet e Qeverisë të marra në mbledhjen e saj të datës 07.09.1998, situata akoma lë për të dëshiruar dhe kjo është një nga faktorët që disa nga këta të ardhur të marrin vendime të dëshpëruara si largimi me gomone”*. Kritikkat e tij konfirmuan problematikat strukturore dhe menaxhuese, të cilat ishin detyrë e qeverisë, si dhe bënë përgjegjës faktin se *“nga ndryshimet që ndodhen në Qeveri është lënë në hije koordinimi i punëve dhe zbatimi i detyrave të të gjitha dikastereve për të ardhurit nga Kosova”*.²

Në gusht 1998 u arrestuan disa ish-zyrtarë të lartë drejtues të opozitës, disa ditë më vonë u vra ish-kryetari i PD-së, Azem Hajdari,

¹ Konkretisht, ministra të Brendshëm ishin: Belul Çelo dhe Ali Kazazi (PD), Neritan Ceka (PS-PAD), Perikli Teta (PAD-PS), Petro Koçi (PS), Spartak Poçi (PS), Ilir Gjoni (PS), ministra të Mbrojtjes ishin: Shaqir Vukaj (PS), Sabit Brokaj (PS), Luan Hajdaraga (PS), Ismail Lleshi (PS).

² Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 24.02.1999, 196.

dy ngjarje që çuan në rënie të qeverisë dhe rikthim të konfliktit të ashpër, ndërkohë që në shumicën kohore të viteve 1997-1999 në shenjë proteste opozita bojkotoi Parlamentin. Në shtator 1998, për shkak të një kërcënimi terrorist nga jashtë u mbyll përkohësisht edhe Ambasada amerikane në Tiranë, ambasada e cila *de facto* përbënte aktorin me ndikim më të madh politik në vend. Fokusi kryesor perëndimor ndaj Tiranës, asistenca për rikthimin e normalitetit dhe ndihma emergjente për ushtrimin e funksioneve bazë të shtetit, përfshirë kontrollin e territorit, erdhi në kontrast me pretendimet dhe pritshmëritë ndaj elitës së re drejtuese në raport me përgjegjësitë kushtetuese në raport edhe me Kosovën. Në Kosovë ndodhi gjithashtu procesi i kalimit nga rezistenca paqësore tek ajo gjithnjë e më shumë aktive e ushtarake. Radikalizimi i rezistencës vinte në kontrast me fundin e radikalizimit të situatës në Shqipëri (1997) dhe synimin për rikthim të normalitetit shoqëror e shtetëror.

Viti 1998 ishte vit i përpjekjeve për rikthimin e normalitetit. Falimentimi i firmave piramidale e zhyti vendin në krizë sociale dhe një operacion ushtarak ndërkombëtar “Alba” u dërgua në Shqipëri në muajt prill-gusht 1997 për të ndihmuar sigurinë publike dhe menaxhimin e ndihmave. Sipas përvojave të njëjta më 1991 dhe 1997, kriza e brendshme politike dhe ekonomike u shoqërua me valë të re emigracioni dhe dobësi të strukturave të sigurisë. Emigrimi ishte aq masiv, sa bazuar në të dhënat e INSTAT-it numri i qytetarëve që emigruan nga Shqipëria para marsit të vitit 1999 ishte më i madh sesa numri i atyre që emigruan nga Kosova në drejtim të Shqipërisë.³ Valët e emigrimit vijuan masivisht edhe gjatë luftës. Vetëm në një ditë, më 17 prill agjencia italiane e lajmeve informoi se rreth 1 500 persona arritën në brigjet e Puglias në Itali⁴ dhe kjo ishte shifër e përsëritur që arriti në më shumë se 20 mijë.⁵ Bilanc kritik u shënua edhe në

³ INSTAT (2004). Migracioni në Shqipëri në vitin 2001; si dhe Mary Ward Loreto (2019). Raporti analitik për Migrimin e shqiptarëve, Geer, Tiranë, 2019, 82.

⁴ ATSH (1999). Valë emigrimi drejt Italisë, 18 prill 1999.

⁵ Martin Smith. (2000). Albania 1999-2000, Conflict Studies Research Centre, 1

aspektin e sigurisë. Numri i të vrarëve në Shqipëri ishte në kuota shumë të larta. Më 1997 ishin regjistruar 1 542 të vrarë, më 1998 u raportuan 573 të vrarë.⁶ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit numëronte 432 të vrarë me armë gjatë vitit 1999, pa llogaritur vrasjet e paregjistruara. Midis të vrarëve ishin edhe dy punonjës të OSBE-së, gjë që çoi në mbylljen e zyrës së kësaj organizate në Tropojë.⁷

Raportet amerikane konfirmonin se mbi 491 punonjës policie u pushuan nga puna gjatë vitit për shkak të paaftësisë, mungesës së disiplinës apo shkeljeve të ligjit⁸ dhe se shqetësues mbetej fakti se oficerët e policisë janë kryesisht të pa trajnuar dhe shpesh jo të besueshëm.⁹ Raportimet ndërkombëtare konfirmonin se një vit pas rifitimit të pushtetit, qeveria Nano është konsumuar dhe ka imazh negativ. Korrupsioni dhe lufta e brendshme kanë krijuar pasoja të rënda. Qeveria ka dështuar gjithashtu në trajtimin e problemeve të rendit dhe ligjit, rimëkëmbjes ekonomike dhe demokracisë dhe se pozicioni i kryeministrit Fatos Nano është minuar më tej nga kriza në Kosovë, të cilën opozita po e shfrytëzon, dhe nga fluksi i refugjatëve kosovarë.¹⁰ Në mungesë të një politike të brendshme të qëndrueshme dhe efektive Tirana zyrtare nuk mund të kishte një politikë të jashtme aktive. Përpjekja për të krijuar teza të reja dhe për të qenë sa më afër tezave të prezantuara nga shtete të tjera brenda BE-së ose zyrtarë amerikanë të përfshirë në misione të ndryshme në rajon, krijoji hendek

⁶ MPB. (2017). Të dhëna për vrasjet ndër vite, 1990-2017. Gazeta Panorama, 15.12.2017.

⁷ Department of State (DOS). (2000). 1999 Country Reports on Human Rights Practices Released by the Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor U.S. Department of State, February 25, 2000.

⁸ U.S. Department of State (2000). Country Reports on Human Rights Practices 1999, Released by the Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor U.S. Department of State, February 25, 2000.

⁹ U.S. Department of State (2000). Country Reports on Human Rights Practices 1999, Released by the Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor U.S. Department of State, February 25, 2000.

¹⁰ Christophe Chiclet (1998). Albania exposed, Monde diplomatique, <https://mondediplo.com/1998/07/03alban>

midis pritshmërive brendashqiptare dhe qëndrimeve zyrtare.

Shqipëria politike humbi ndjeshëm në peshën dhe partneritetin e mundshëm të saj jo vetëm për shkak të krizës shtetërore dhe shoqërore të vitit 1997-1998, apo paqëndrueshmërisë së qeverive, por edhe për shkak të nivelit të korrupsionit e arrogancës së pushtetit të ri, aq edhe nga përpjekja për t'u imponuar me nisma të pakoordinuara me partnerët perëndimorë. Një shembull i tillë ishte takimi midis kryeministrit Nano dhe presidentit Millosheviq në Kretë (Greqi), i cili rezultoi se nuk ishte i konsultuar dhe nuk dha as rezultat. Takimi krijoi konfuzion dhe dobësoi edhe pozitën e saj në Prishtinë.¹¹ Po ashtu, prirja e Tiranës zyrtare për të promovuar zgjidhje më të vogla sesa kërkesat e vet Kosovës u bënë vijë zyrtare.

Qasjen më problematike e pati qeveria Nano. Duke mos qenë të mirinformuar dhe as pjesë e bisedimeve jopublike në nivelet e larta evropiane, si dhe duke dashur të fitojë mbështetje ndërkombëtare përmes qëndrimit moderator, qeveria Nano elaboroi teza e qëndrime në e vunë Tiranën zyrtare jo në krah, por në konflikt me linjën politike të prezantuar nga lidershipi politik i Kosovës rreth presidentit Rugova. Kjo situatë u përsëri edhe disa muaj përpara krizës dhe luftës në Kosovë. Për shembull, në disa takime dhe deklarime ndërkombëtare gjatë vitit 1998, kryeministri Nano kritikoi funksionimin e strukturave paralele në Kosovë dhe këshilloi liderët politikë të shqiptarëve në Kosovë se *“duhet të heqin dorë nga politika e bojkotit, si një politikë e cila nuk u ka dhënë asnjë rezultat deri më tani”*. Mesazhi i tij sugjeronte që ata duhet *“të përfshihen në jetën politike të vendit ku jetojnë”*, kohë kur zyrtarisht ishte Serbia, apo se *“institucionet paralele nuk janë zgjidhje, përkundrazi, vetëm radikalizojnë shoqëritë që i kanë krijuar”*.¹² Në bisedimet midis të dërguarit amerikan Hollbruk dhe kryeministrit Nano, në pranverën e vitit 1998 diplomati

¹¹ Remzi Lani (1998). From Nano-Milosevic to Rugova-Milosevic, AIM Pristina, 26 May, 1998.

¹² The Hellenic Resources Institute (HRI) (1998). Nano Rhetoric, Music to the Ears of Milosevic, 1998, shiko link: <https://www.hri.org/news/balkans/kosova/1998/98-02-10.ksv.html>

amerikan deklaroi *“ashtu si ne edhe pjesa tjetër e komunitetit ndërkombëtar mbështesim plotësisht integritetin territorial të Shqipërisë, edhe Shqipëria mbështet shumë qartë integritetin territorial të Jugosllavisë”*.¹³

Një prej zërave aktivë në Kuvendin e Shqipërisë, deputeti Sabro Godo, në korrik 1998 kritikoi qeverinë se *“i mungon një strategji e studiuar, e kuptueshme për qytetarët e që do të shërbente si bosht i veprimtarisë së saj”*, se *“qëndrimi ndaj Kosovës ka qenë dhe mbetet konfuz dhe shpesh enigmatik”*, *“Kryeministri ka folur për Kosovën sipas asaj që i ka dalë përpara, pa u konsultuar me ndokënd. S’është bërë ndonjë mbledhje e Këshillit të Ministrave për këtë temë, kryeministri s’ka bërë ndonjë konsultim me forcat politike dhe duket se as ka pyetur për 3 rezolutat e Kuvendit për Kosovën”*.¹⁴

Duke iu përgjigjur kritikave Nano tha ndër të tjera se *“Shqipëria e ka njohur Kosovën si republikë, por edhe me këtë njohje nuk e përcakton se çfarë republike federative brenda Jugosllavisë, republikë të pavarur, apo siç e kërkon ndonjë në kuadrin e ndonjë ballkaniade... Problemi i Kosovës, sipas këtij qëndrimi, nuk shihet jashtë kufijve të ish-Jugosllavisë, por në kuadrin e një autonomie vetëqeverisëse të zgjeruar”*¹⁵, një pozicion jo natyral për Tiranën zyrtare në raport me kërkesën e vet Kosovës. Bazuar edhe në këto raste një raport ndërkombëtar i ICG konkludoi se *“qeveria e re e Fatos Nanos, e udhëhequr nga socialistët, ka komplotuar një rrugë shumë të ndryshme nga ajo e paraardhësit të saj, duke zhgënjyer*

¹³ U.S. Officials meet with Albanian Prime Minister Nano, 11 May 1998 Transcript: Holbrooke, Gelbard, Albanian Prime Minister Nano

<https://reliefweb.int/report/albania/us-officials-meet-albanian-prime-minister-nano>

¹⁴ Kuvendi i Shqipërisë (1998). Punime të Kuvendit. Legjislatura e 15-të, 10.07.1998, 1376-1377.

¹⁵ Kuvendi i Shqipërisë (1998). Punime të Kuvendit. Legjislatura e 15-të, 10.07.1998, 1379.

shumë liderët shqiptarë të Kosovës”¹⁶ megjithatë vlerëson se nga muaji në muaj politika shqiptare po ndryshon si rezultat i dhunës së vazhdueshme dhe presionit popullor në vend.

Aq e vonuar dhe e papërgatitur në aspektin strategjik ishte elita vendimmarrëse në Tiranë, sa vetëm disa muaj përpara ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë kryeministri nuk besonte në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s, ndërsa deklaroi në Parlament se *“Qeveria e Shqipërisë ka deklaruar se nuk e mbështet punën e saj në hipoteza, as në ëndërrime romantike dhe në shpresa që kapërcejnë kufijtë e legjitimitetit të organizatave të sigurimit dhe të vendimmarrjes në skenën ndërkombëtare apo që djemtë e Evropës, kaubojtë dhe rambot e Amerikës do të vijnë të luftojnë serbët dhe t’u dhurojnë pavarësinë shqiptarëve të Kosovës*”.¹⁷

Edhe në fazën fundore në mars 1999 Tirana zyrtare e gjykonte të pamundur jetësimin e kërkesës së Kosovës për pavarësi¹⁸, ndërkohë që opozita me qasje më radikale, për shkak të veprimeve të saj gjatë vitit 1997 dhe bojkotit të Parlamentit u përjashtua tërësisht nga procesi konsultues dhe ndikues. Në mënyrë simbolike vonesën e dëshmon edhe fakti se presidenti i RSH-së e dha mesazhin publik drejtuar vendit rreth 48 orë pas mesazheve të dhëna nga krerët e shteteve kryesore perëndimore dhe nisjes së sulmit të NATO-s. Presidenti Meidani deklaroi se *“ne jemi në këmbë dhe përgatitemi për çdo situatë. Ne e kemi mbajtur vendin tonë jashtë provokacioneve e akuzave që do ta shfokusonin Kosovën si thembra e Akilit në rajon. Shqipëria në këtë moment është në mbështetje të të gjitha veprimeve ndërkombëtare për ta zgjidhur konfliktin*”. Mesazhi përmbledhej në shprehjen *“Kosova është problemi i problemeve. Në sytë tanë po*

¹⁶ International Crisis Group (ICG) (1998). The View from Tirana: the Albanian dimension of the Kosovo crisis, 10 Jul 1998, see more at <https://reliefweb.int/organization/icg>

¹⁷ Kuvendi i Shqipërisë. (1998). Punime të Kuvendit. Legjislatura e 15-të, 10.07.1998, 1379.

¹⁸ Paskal Milo. (2009). Ditari i një ministri të jashtëm, Toena, 2009, 154.

*ndodh një zhvillim i madh. Le të jemi të denjë për të qenë në një hap me këtë zhvillim”.*¹⁹

Si gjatë qeverisë Nano edhe gjatë qeverisë Majko dhe më pas qeverisë Meta Tirana zyrtare u përfshi në diskutime rreth legjitimitetit të lidhshimit politik në Kosovë. Bazuar në marrëdhëniet e mëparshme preferenciale midis opozitës së djathtë (Partia Demokratike) dhe LDK-së së presidentit Rugova, e majta në Shqipëri (Partia Socialiste) ishte kritike e vazhdueshme ndaj Rugovës dhe mbështetëse e çdo lëvizjes kundër tij. Kur në Rambuje u njoftua se është krijuar një qeveri e re e drejtuar nga Hashim Thaçi, Tirana zyrtare e njohu atë. Kur LDK-ja deklaroi mosdakordësinë ndaj saj, Tirana nuk e rivlerësoi qëndrimin. Në ngjarjet e shtatorit 1998 anëtarë të LDK-së dhe qeverisë Bukoshi u akuzuan për mbështetje të protestave të dhunshme të opozitës²⁰, disa ditë më pas në Tiranë u vra në mënyrë të mistershme ministri i Mbrojtjes i qeverisë së Kosovës. Raportet e e ngrira u zëvendësuan nga kontaktet personale, të cilat nuk ofronin të dhëna cilësore informative dhe as mundësi për koordinime strategjike.

Hendeku i krijuar në besimin dhe komunikimin reciprok u thellua pikërisht edhe gjatë vitit 1999. Tirana bëri përpjekje të pasuksesshme për të organizuar një takim paraprak të liderëve politikë shqiptarë të Kosovës në prag të bisedimeve në Rambuje. Nga ana tjetër, në së paku dy mbledhje të qeverisë dhe dy debate parlamentare lidhur me Kosovën u diskutua gjerësisht lidhur me qëndrimin zyrtar ndaj presidentit Rugova, qeverisë Thaçi dhe qeverisë Bukoshi. Nga procesverbalet e mbledhjeve të qeverisë rezulton se komuniteti ndërkombëtar ushtroi presion ndaj Tiranës për të pasur një qasje më pozitive ndaj Rugovës dhe për ta konsideruar atë partner kryesor pas luftës. Ministri Milo informoi qeverinë më 11 maj se këtë linjë po ndjek Italia, Gjermania, Franca, Britania dhe SHBA-ja, linjë me të

¹⁹ Rexhep Meidani (1999) Mesazh i presidentit të Republikës drejtuar kombit shqiptar, ATSH, 26 mars 1999.

²⁰ Kuvendi i Shqipërisë (1999). Punime të Kuvendit. Legjislatura e 15-të, 07.06.1999, 570.

cilën qeveria dhe vetë ministri Milo ishin kundër me argumentin se *“kur i gjithë komuniteti ndërkombëtar, me të cilin ne bashkëpunojmë tani për të gjetur një zgjidhje për Kosovën, po orientohet drejt Rugovës, për ta nxjerrë atë si lider të parë dhe interlokutor, ne me të drejtë në të gjitha takimet kemi thënë mos bëni diferencime të liderëve shqiptarë të Kosovës, partnerët tanë ndërkombëtarë bëjnë të kundërtën, ngrijnë Rugovën, ulin të tjerët. Pra, siç e shikoni nuk jemi me në unison për një çështje shumë të rëndësishme”*.²¹

Po ashtu, në kulmin e krizës në Kosovë më 1 prill 1999 qeveria zhvilloi një debat lidhur me këtë temë, gjatë shqyrtimit të aktit për miratimin e grantit prej 1 milionë DM të akoruar nga qeveria Bukoshi si ndihmë për përballimin e nevojave e të ardhurve nga Kosova. Akti u shty tri ditë në mungesë të një opiniononi të qartë mbi legjitimitetin e kësaj qeverisë dhe më pas në qeveri shumica e ministrave (kryesisht Angjeli, Rama, Bufi, Meksi, Koçi etj.) u shprehën me gjuhë të ashpër kundër Bukoshit dhe ambasadorit Iljaz Ramajli, duke sugjeruar t’u kërkohet atyre, siç ministri i Financave, Anastas Angjeli, u shpreh *“merr valixhen ik atje në bankë dhe derdhi në llogari”*²² pa kërkuar dhe as lëshuar akt pranimi si qeveri. Në fund të diskutimit Qeveria vendosi t’ia kalojë Parlamentit përgjegjësinë për të vendosur cila qeveri do të njihej dhe ndërkohë, vendosi refuzimin e ndihmës së ofruar nga qeveria në ekzil.

Situata në post-krizë dhe ndikimi në politikën e jashtme

Nga të dhënat arkivore rezulton se precipitimi i ngjarjeve ishte i shpejtë dhe kushtëzoheshin sa nga zhvillimet në terren aq edhe nga niveli i përfshirjes së diplomacisë perëndimore. Në këtë kuadër Shqipëria mbeti në pozita pritëse. Ajo nuk pati sukses as në nisma përfituese lobuese, si p.sh., fakti se gjatë bisedimeve me vendet

²¹ AQSH. V.1999, F.490, D.414. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave 11.04.1999, 8.

²² AQSH. V.1999, F.490, D.348. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave 01.04.1999, 4.

anëtare në NATO ajo lloji së bashku me vendet fqinje rreth Jugosllavisë, të cilat mund të përfshihen direkt ose indirekt në konflikt, që të mund të marrin statusin e vëzhguesit në momentet e fundit të kësaj konference (Rambujë, shënimi im)”.²³

Referuar dokumentacioni zyrtar shtetet perëndimore, sidomos SHBA-ja, nuk preferonin një rol aktiv të Shqipërisë në Kosovë, përfshirë asistencën ushtarake apo shtetërore. Çdo veprim i tillë shihej si burim rreziku për planet e NATO-s dhe për sigurinë në Ballkan. Fuqitë perëndimore nuk mbështetën përfshirjen e mundshme të Shqipërisë në procesin e Rambujesë dhe as për koordinimin paraprak të faktorit shqiptar në Kosovë. Ato ishin në tërësi kritike për kapacitetet e Shqipërisë për kontrollin kufitar dhe të trafikut të armëve si dhe për aftësinë e autoriteteve dhe të opozitës për të shmangur konfliktualitetin politik. Arrestimet e disa zyrtarëve të lartë të opozitës në gusht 1998 u kritikuan ashpër dhe publikisht nga SHBA-ja²⁴, ashtu siç u veprua edhe me aktet e dhunshme të 14 shtatorit ndërmarrë nga opozita. Në tërësi kancelaritë perëndimore vlerësonin se Shqipëria kishte një rol për të luajtur, atë të evitimit të krizave brenda saj dhe rritjen e kapaciteteve për të krijuar institucione më funksionale dhe për politika më aktive kundër korrupsionit dhe për mirëqeverisjen.

Ilustrimi i kësaj teze del në pah nga së paku dy argumente konkrete. Për shkaqe sigurie dhe problematika lokale disa vizita të zyrtarëve të lartë amerikanë u anuluan ose u zhvendosën për arsye sigurie në Maqedoninë Veriore. Raporti i ICG-së²⁵ citon vizitën e planifikuar të Sekretares së Shtetit, Madeline Albright, në qershor 1999, të sekretarit të Mbrojtjes William Cohen në korrik, të Ambasadori në Kombet e Bashkuara, Richard Holbrooke, në gusht dhe në fund edhe vizita e presidentit Klinton, i cili e shmangu Tiranën

²³ AQSH. F.490, V.1999, D.174. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 3.

²⁴ AQSH. F.490, V.1998, D.538, Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 28.08.1998, 72.

²⁵ International Crisis Group (ICG 2000). Balkans Report N° 87, Albania: State of the Nation, 01.03.2000, 5-6.

në turin e tij të fundit.

Ilustrim tjetër është edhe vetë leximi i procesverbalit të mbledhjes së qeverisë në ditën e sulmit të NATO-s ndaj Serbisë. Nga raportimi i ministrit të Financave në qeveri rezulton se donatorët ndërkombëtarë i kërkuan qeverisë të ndihmojë me problemet e brendshme duke u dhënë zgjidhje atyre që janë me ndjeshmëri publike, duke u marrë kryesisht me problemin e transparencës së skemave piramidale.²⁶ Edhe pas sqarimeve nga qeveria dhe përpjekja e saj për ta zhvendosur diskutimin te situata në Kosovë, përsëri ata kërkonin më shumë informacion dhe garanci lidhur me kreditorët, transparencën dhe kapacitetet për kompensimet financiare.

Nga leximi i dokumentit të takimit rezulton se diplomatët i frikësoheshin trazirave sociale që mund të shkaktoheshin, por edhe përdorimit të burimeve të ndihmës financiare në funksion të kreditorëve të piramidave. Të njëjtin shqetësim konfirmuan edhe disa ministra në qeveri, të cilët ndjenin lodhjen e publikut nga pritshmëria dyvjeçare për premtimin e kthimit të parave. Në këtë kuptim ishte e pritshme që Shqipëria, duke qenë vetë subjekt i asistencës financiare e administrative si dhe i ndihmës humanitare perëndimore, nuk mund të ishte njëherësh edhe subjekt e partner efektiv për të asistuar krizën e Kosovës.

Kjo konfirmohet edhe nga kujtimet e gjeneralit Wesley Clark, i cili në librin e tij e përmend shumë pak Shqipërinë dhe bisedimet me autoritetet e saj. Ai citon takimin me gjeneralin Andoni dhe më vonë me kryeministrin Majko. Në detajet e shumta të diskutimeve dhe të vendimeve të cituara në libër Shqipëria citohet vetëm në raste minore si aktor, kryesisht në raportimet nga terreni, vizitat apo kërkesat brenda kuadrit të NATO-s. Në kujtimet e tij, Clark citon rastin kur bisedoi me kryeministrin lidhur me aksesin ndaj NATO-s. Ai shkruan: *“Kryeministri Majko aprovoi çdo kërkesë. A mund të shfrytëzojmë ndonjë aeroport shtesë? Natyrisht përdorni të gjitha aeroportet. A*

²⁶ AQSH. F.490, V.1998, D.262, Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 28.08.1998, 47.

*mund të rregullojmë rrugën për në Kukës? Po, veproni. Po rrugën për në Shkup? I keni në dispozicion të gjitha rrugët dhe objektet e qeverisë, merrni gjithçka që ju nevojitet”.*²⁷

Fjalët e kryeministrit të kohës reflektojnë thelbin, - ndonëse e varfër, e brishtë dhe e pafuqishme në aspektin ushtarak, Shqipëria ishte 100% në dispozicion të NATO-s dhe aksionit të Perëndimit në Kosovë. Ajo ishte gjithashtu tërësisht e varur nga asistenca perëndimore, pa pothuajse asnjë aset për t’u imponuar në bisedime apo kërkesa të ndryshme. Reagimi si komb nuk ishte i vlefshëm edhe për shkak të ndarjeve të krijuara, ndërsa autoritetet qeverisëse në Tiranë vuanin nga kriza e legjitimitetit dhe e mbështetjes publike.

Në këto rrethana kërkesa kryesore e Shqipërisë gjatë vitit 1998 dhe fillimit të vitit 1999 ishte sigurimi i mbrojtjes së vendit në rast lufte, përmes vendosjes së trupave të NATO-s. Kërkesa nuk u plotësua fillimisht, por NATO-ja dhe aleatët perëndimorë deklaruan vazhdimisht se integriteti dhe territorialiteti i Shqipërisë është i garantuar. NATO-ja hapi zyrë në Tiranë në qershor 1998, për të mundësuar asistencën autoriteteve shqiptare *“në adresimin e pasojave të mundshme të krizës në Kosovë, duke përfshirë ndihmën e mundshme në komunikim, kontrollin kufitar dhe çështjet e refugjatëve”*.

Hapja e zyrës sinjalizoi interesin e Aleancës për të zhvilluar marrëdhënie më të ngushta me autoritetet shqiptare në zbatimin e aktiviteteve të PfP.²⁸ Ndërmjet marsit 1998 dhe majit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe kryeministrat shqiptarë u takuan pesë herë, - tri herë në Tiranë dhe dy herë në Bruksel, - për të diskutuar situatën në Kosovë.²⁹ Shqipëria ishte konsekuente duke kërkuar nga aleanca që të ndërhynte në Kosovë për të ndalur “spastrimin etnik” dhe për të rivendosur paqen dhe stabilitetin në rajon. Klark kujton se

²⁷ Wesley Clark (2003). Të bësh luftë moderne. Artini, Prishtinë, 299.

²⁸ NATO (1998). NATO Opens NATO/Partnership for Peace Cell in Albania, news release, May 29, 1998.

²⁹ Human Rights Watch (2000). Human Rights Watch World Report - Albania, 1 December 1999.

gjatë vizitës së tij në Tiranë ministri i Mbrojtjes Hajdaraga, i deklaroi se atij se me vendosjen e trupave të NATO-s “*Shqipëria kishte shpëtuar*”.³⁰

Në orët e vota të datës 24 mars 1999 kryeministri deklaroi në qeveri dhe publik se “*ne sapo kemi marrë një mesazh nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, për mbështetje të plotë të Aleancës për integritet territorial, pavarësinë politike dhe sigurinë e vendit, Shqipërisë*». Mesazhi u dha direkt në publik, duke shtuar se “*dua t’i dërgoj një mesazh solidariteti të plotë gjithë popullit të Kosovës martire dhe luftëtarëve të UÇK-së dhe të përsëris se në këto ditë të vështira, ne jemi pranë tyre. Tashmë ka rënë ora e provës për të gjithë kombin shqiptar, është një provë patriotizmi, qytetaria e vitaliteti ynë në këtë përpyekje vendimtare*».³¹

Apeli ishte edhe një përgjigje ndaj debatit të vazhdueshëm në Qeveri dhe Parlament mbi nivelin e sensibilizimit publik dhe të nevojës për dhënien e mesazhit për solidaritet dhe kontroll të situatës. Qeveria kishte konstatuar më 22 mars 1999 se “*një pjesë e njerëzve duken shumë indiferent ndaj asaj që ndodh, një pjesë duken të frikësuar, një pjesë shumë të pamotivuara, kurse një pjesë duket sikur gjithçka ndodh atje është një spekulim nga forcat që janë në pushtet*”.³²

Nga politika te sfidat e administrimit të krizës

Konflikti në Kosovë më 1999 në aspektin humanitar përfshiu të gjithë Shqipërinë, por në aspektin konkret ushtarak, social, teknik dhe administrativ përfshiu sidomos zonën veriore dhe veriperëndimore. Kukësi u bë stacioni kryesor dhe simbol i krizës.

Nga fillimet e incidenteve në fundin e vitit 1997 dhe deri në nisjen e luftës në mars 1999 Shqipëria kishte kohë të mjaftueshme për

³⁰ Wesley Clark (2003). Të bësh luftë moderne. Artini, Prishtinë, 299.

³¹ AQSH. F.490, V.1999, D.262. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 24.03.1999, 52.

³² AQSH. F.490, V.1999, D.262. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 24.03.1999, 19.

të marrë masat më optimale për përgatitje, sidomos në aspektin administrativ dhe të kontrollit të territorit. Nga të dhënat arkivore rezulton se ky proces parapërgatitur nuk kishte ndodhur dhe Tirana zyrtare nuk reflektoi as nga gabimet e dobësitë e fazës së parë të refugjatëve në verën e vitit 1998. Zona veriore dhe verilindore ishte njëherësh zona më e varfër, më pak e zhvilluar, më e izoluar dhe për shkak të migrimit të shumëfishtë edhe zona më me pak kapacitete e burime njerëzore në dispozicion. Problematika më e madhe ishte mungesa e kontrollit të plotë të territorit nga organet shtetërore dhe për pasojë, mungesa e fuqisë për zbatimin e ligjeve.

Disa dëshmi të zyrtarëve të lartë e konfirmojnë situatë dhe problematikën. Në mbledhjen e qeverisë më 28 gusht 1998 kreu i shërbimit sekret, Fatos Klosi, duke folur për situatën e krijuar me të ardhurit në Tropojë tha se *“atje situata është më e vështirë, pasi shteti atje është relativisht i dobët, dmth ndihet pak. Dhe këtë situatë po e shfrytëzojnë ata elementë që shfrytëzojnë shtetin e dobët, kontrabandistët e armëve. Atje lulëzon kjo kontrabandë dhe të gjithë ata që mundohen të përfitojnë nga situata të tilla, lidhur me shpërndarjen e ndihmave, lidhur me fluksin e refugjatëve”*.³³

Në të njëjtën mbledhje zv/kryeministri islami raportoi nga vizita në Tropojë se drejtuesi i rendit i kishte deklaruar në takim se *“unë jam jashtë loje, unë nuk mund të veproj për shumë arsye”* dhe *“situata është jashtë kontrollit”*.³⁴ Për më tepër zv/kryeministri citoi drejtuesit lokalë të jenë shprehur se menaxhimi i të ardhurave u krye kryesisht falë mikpritjes së banorëve, sepse po të ishte për qeverinë do ishte e pamundur. Ai shtoi se organizatat ndërkombëtare nuk funksionojnë dot, ndaj komuniteti ndërkombëtar ka vlerësuar se situata atje është në mungesë të plotë sigurie³⁵, si dhe sugjeroi me të

³³ AQSH. F.490, V.1998, D.538. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 28.8.1998, 6.

³⁴ AQSH. F.490, V.1998, D.538. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave 28.8.1998, 22.

³⁵ AQSH. F.490, V.1998, D.538. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 28.8.1998, 12.

drejtë një program masash nga Qeveria dhe Parlamenti, të cilat faktikisht nuk u morën deri në mars 1999.

Edhe në raportimin e ministrit të Mbrojtjes mbi gjendjen në Shkodër vlerësohej se ishin shqetësuese. Aty *“shëfat e policisë donin të largoheshin sepse thonin se e kemi kryer detyrën tonë dhe situata është shumë e vështirë”*, ka mosbesim të theksuar *“midis SHIK, Rendit dhe Prokurorisë”*, *“situata e depove në veri është e vështirë, ka rrjedhje të municioneve/armatimeve nga depot nga presioni i kontrabandës”*, *“rendi ka nevojë për policinë ushtarake”*³⁶, etj.

UNHCR konfirmoi problematikën dhe raportoi vështirësi për realizimin e ndihmave emergjente në zonat veriore, kryesisht për shkak të rritjes së grabitjeve të armatosura, vjedhjeve të makinave me armë dhe luftimeve mes klaneve familjare vendase, të kombinuara me një prani ushtarake të grupeve të UÇK-së.³⁷ Sipas organizatës, mjedisi operacional për agjencitë humanitare në veri është jashtëzakonisht i tensionuar.

Pasiguria dhe incidentet detyruan organizatat ndërkombëtare të kërkojnë zgjidhje alternative duke u larguar nga zona dhe vetë UNHCR-ja e zhvendosi zyrën e saj satelitore në Shkodër. Të njëjtat përshkrime gjenden kryesisht në disa raporte ndërkombëtare zyrtare dhe raporte mediatike. Në një raport të Grupit Ndërkombëtar të Krizave vlerësohej se *“mungesa kronike e infrastrukturës në Shqipëri do të thotë se furnizimet me energji elektrike janë të pakta, rrugët ndonjëherë janë të pakalueshme, furnizimet me ujë janë të çrregullta dhe komunikimet telefonike të kufizuara dhe jo të besueshme”*. Në raport thuhet se kur ekipi i ekspertëve të NATO-s vizitoi Kukësin për të shqyrtuar kushtet për dislokim trupash, ata vlerësohen se do të

³⁶ AQSH. F. 490, V.1998, D.538. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 28.8.1998, 11-13.

³⁷ UNHCR Global Appeal 1999 - Albania, 1 December 1998

<https://www.unhcr.org/publications/unhcr-global-appeal-1999-albania>

duheshin të paktën katër muaj përpara se infrastruktura e nevojshme teknike të ishte gati për përdorim.³⁸

Qeveria u vu nën presion politik dhe mediatik për refuzimin e vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme në zonën verilindore. Sipas saj, gjendja e jashtëzakonshme *“do të ishte e parakohshme, mbasi do të shkaktonte angazhimin e të gjitha forcave dhe mjeteve vetëm në një drejtim, që do të vështirësonte vazhdimin e punës në sektorët e tjerë ndihmës, që gjithashtu janë jetik për mbajtjen e situatës nën kontroll”*.³⁹ Në fakt ishte vetë kryeministri që propozoi në qeveri vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme, disa ministra gjithashtu, por nuk pati dakordësi të plotë.

Për shkak të gjendjes së brishtë në zonat verilindore dhe ato kufitare NATO kërkoi disa herë vendosjen e saj në vijën kufitare për të shmangur lëvizjen e trupave të parregullta dhe sidomos trafikun e armëve. Kërkesa krijoi presion politik ndaj qeverisë në Tiranë dhe e vuri atë në pozitë të vështirë. Në debatin e zhvilluar në Këshillin e Ministrave ministri i Jashtëm Milo (PS) informoi se kërkesa u refuzua nga pala shqiptare, por kjo krijoi dyshime nëse ka diçka për të fshehur. Nëse pranojmë këtë do të mund të ballafaqohemi me reagimin e opinionit të brendshëm politik dhe publik shqiptar, por edhe të vet shqiptarëve në Kosovë, thotë ministri.⁴⁰ Bllokimi i lëvizjeve në kufi do të ishte goditje e madhe për forcat ushtarake të UÇK-së, si dhe do të krijonte izolim më të madh të Kosovës në raport me Shqipërinë, ndërkohë që pritshmëria dhe deklaratimet publike ishin për të kundërtën, mbështetjen me të gjitha mjetet dhe forcat në dispozicion. Në mbledhjen e 24 marsit kryeministri informoi qeverinë se pas Rambujesë liderët shqiptarë të Kosovës kanë kërkuar *“të kenë të drejtën e vetëmbrojtjes”*, çfarë nënkupton furnizimin me armë dhe

³⁸ International Crisis Group (ICG) (1998). The View from Tirana: the Albanian dimension of the Kosovo crisis, 10 Jul 1998, see more at <https://reliefweb.int/organization/icg>

³⁹ Kuvendi i RSH. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 22.4.1999, 397

⁴⁰ AQSH. F.490, V.1999, D.174. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 4.2.1999, 4.

rezistencën e armatosur. Kryeministri dhe presidenti u dakorduan me kërkesën duke urdhëruar Ministrinë e Mbrojtjes për marrjen e të gjitha masave, me sugjerimin që *“kjo situatë të mos degjenerojë në situatë trafikesh apo implementime interesash të paskrupullta”*.⁴¹

Në mars të 1998 duke komentuar ardhjen e refugjatëve nga Kosova ministri i Brendshëm, Neritan Ceka, pranoi në Kuvendit se *“deri tani mungojnë strukturat adekuate, mungon legjislacioni adekuat, mungon edhe përkrahja e institucioneve ndërkombëtare, të cilat e kanë trajtuar. Dua të them që ende jemi të papërgatitur për një gjë të tillë”*.⁴² Lidhur me ardhjen e refugjatëve ai shtoi se *“dua të them që ende jemi të papërgatitur për një gjë të tillë dhe është rasti që ta ngre këtë shqetësim, sepse duhet filluar menjëherë, për t'i bërë ballë një vale të tillë”*.⁴³

Një vit më vonë situata nuk kishte ndryshuar, baza ligjore gjithashtu. Referuar vendimmarrjes parlamentare dhe ekzekutive rezultoi se Shqipëria e hartoi legjislacionin mbi emergjencat dhe Strategjinë e Sigurisë Kombëtare vetëm pas krizës në Kosovë dhe me këshillën këmbëngulëse amerikane, dhe se aktet zyrtare për ngritjen e strukturës menaxhuese të emergjencës, për rezervat shtetërore etj., u morën vetëm në mars - prill 1999⁴⁴ nën presionin e zhvillimeve në terren. Grupi i Menaxhimit të Emergjencave (EMG), një mekanizëm i përbashkët koordinues kombëtar-ndërkombëtar i drejtuar nga qeveria, u krijuar me sugjerimin e OSBE-së dhe SHBA-së vetëm më 31 mars 1999⁴⁵, disa ditë pas nisjes së sulmit ajror nga NATO-ja dhe fluksit të

⁴¹ AQSH. F.490, V.1999, D.261. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 24.3.1999, 1.

⁴² Kuvendi i Shqipërisë (1998). Punime të Kuvendit. Legjislatura e 15-të, 5.3.1998, 407.

⁴³ Kuvendi i Shqipërisë (1998). Punime të Kuvendit. Legjislatura e 15-të, 5.3.1998, 407.

⁴⁴ Afrim Krasniqi (2019). Kosova në aktet zyrtare të shtetit shqiptar 1991-2018, në “Kosova drejt lirisë”, Instituti i Historisë Prishtinë, 220.

⁴⁵ Kosta Barjaba. (2000). Social impacts of the Kosovar refugee crisis in Albania. The World Bank, 2.

parë masiv të refugjatëve. Edhe akti zyrtar për krijimin e grupit ndërministror të punës për përgatitjen e bazës konceptuale ligjore dhe organizative të strukturave të përshtatshme për menaxhimin e krizave doli shumë vonë, vetëm më 15 shkurt 1999. Fokusimi në koordinimin dhe menaxhimin e krizës së refugjatëve dhe ecurisë së luftës ishte e e pashmangshme të kishte pasoja negative për ekonominë e vendit. Prioritet paralel mori edhe nevoja për të rivendosur infrastrukturën e luftës.⁴⁶

Mbyllja e zonave doganore dhe kufitare, bllokimi i aeroportit, administrimi ndërkombëtar i tyre, pasiguria dhe kriza sociale, ndalimi i investimeve të brendshme dhe mungesa e atyre të jashtme, emigrimi etj., u bënë pengesa dhe sfidë e shumëfishtë për Shqipërinë. Ndërkohë që kriza erdhi, ekonomia shqiptare vijonte të vuante efektet e krizës së vitit 1997 dhe të embargos ekonomike të vendosur mbi shtetin jugosllav rreth pesë vjet më parë.⁴⁷ Ato pak burime që kishte qeveria u konsumuan nga barra e madhe e kujdesit për shqiptarët e përzënë nga Kosova, ndërkohë që kjo detyrë u vështirësua gjithashtu për shkak të infrastrukturës së dobët të transportit dhe komunikimit në Shqipëri. Kostot buxhetore sipas FMN-së vlerësoheshin në 144 milionë dollarë amerikanë, ose ekuivalenti me 33 dollarë amerikanë për refugjat në muaj.⁴⁸ Presidenti Meidani me të drejtë përçoi tezën se Shqipëria nuk e përdori krizën për të përfituar dhe se kërkesat e Shqipërisë kanë qenë modeste. Ne kërkuam vetëm 3 dollarë në ditë për person vetëm për ushqim dhe ndihmë mjekësore. Nëse kriza zgjaste deri në dhjetor kostoja financiare ishte 600 milionë dollarë dhe humbjet ekonomike

⁴⁶ Fatos Nano (1998). Security in Southeastern Europe: an Albanian Perspective, in 15th International Workshop on Global Security - Vienna, 19-23 June 1998, <https://csdr.org/98Book/nano98.htm>

⁴⁷ Wesley Clark (1998). Opening remarks, 15th International Workshop on Global Security, Vienna, 19.6.1998.

⁴⁸ International Monetary Fund (IMF), (1999). Albania: Staff Report for the 1999 Article IV Consultation, Request for the Second Annual Arrangement Under the Enhanced Structural Adjustment Facility, and Request for Augmentation (<https://www.elibrary.imf.org/view/journals/002/1999/050/article-A001-en.xml>)

255 milionë dollarë të tjerë. “*Ne nuk duam të përfitojmë nga kjo krizë, por vetëm të mbulojmë shpenzimet tona*”-, tha presidenti për revistën *Newsweek*, më 30 maj 1999.⁴⁹ Në takimin e donatorëve në Bruksel më 26 maj qeveria shqiptare mori premtime prej 200 milionë dollarësh për të përmbushur kërkesat e saj për financim të jashtëm, 160 milionë për shkak të krizës dhe 40 milionë që do të ishin të nevojshme edhe nëse ai konflikt nuk do të kishte ndodhur.⁵⁰

Qeveria mori frymë lirisht fillimisht kur NATO-ja dislokoj rreth 8 mijë trupa, të cilët së bashku me një numër të konsiderueshëm punonjësish të ndihmës ndërkombëtare, parandaluan një fatkeqësi humanitare në shkallë të gjerë⁵¹, si dhe më pas me përfundimin e luftës në qershor. Me të drejtë politikanë të ndryshëm pranuan në Parlament se kriza i tejkaloi kapacitetet e Shqipërisë dhe në asnjë rrethanë asnjë qeveri nuk do të kishte performancë pozitive, ndërkohë që qeveria e vitit 1998-1999 vijonte të kishte mbështetje modeste në publik dhe në spektrin politik.

Emergjencë dhe spontanitet

Disa nga ministrat dhe titullarët e tjerë të shtetit shqiptar të viteve 1998-1999 kanë publikuar libra me ditarë, memorie personale apo analiza, si dhe kanë dhënë intervista periodike, duke u fokusuar kryesisht te meritat personale apo kolektive të menaxhimit të krizës humanitare dhe luftës në Kosovë. Historia e shkruar nga protagonistët e ngjarjeve riskon të jetë subjektive dhe e përzgjedhur. Krahasimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave ku ata kanë qenë aktivë me botimet apo deklaratimet publike të mëvonshme krijojnë kontraste të dukshme.

⁴⁹ Intervistë me Rexhep Meidani (1999). Shelter For The Refugees, Neëseëek International, May 31, 1999 (<https://www.newsweek.com/shelter-refugees-166556>)

⁵⁰ Anastas Angjëli (1999). The Political Impact and Economic Cost to Albania of the Crisis in Kosovo. *Mediterranean Quarterly*, vol. 10 no. 3, 1999, 7-14. Project MUSE.

⁵¹ Freedom House (2000). Freedom in the World 1999 - Albania, 1999. <https://www.refëorld.org/reference/annualreport/freehou/1999/en/91533>

Dokumentacioni arkivor dëshmon se asnjë prej vendimeve të rëndësishme të kohës, përfshirë edhe procesi i Rambujesë dhe aktet e tjera politike, nuk janë ndikuar nga Tirana zyrtare. Ministri i Jashtëm konfirmoi se Shqipëria ndjehej e neglizhuar nga komuniteti ndërkombëtar sidomos në diskutimet për të ardhmen e Kosovës.⁵² Ajo vetëm sa konfirmoi vendimmarrjet e aleatëve perëndimorë ndaj Kosovës, kryesisht në fazën pasvendimmarrjes, si dhe i promovoi ato edhe si pjesë e gjykimit të vet, duke tentuar të shfaqet pjesë e procesit. Kur Solana vizitoi Tiranën qeveria u habit nga kërkesa e tij për të takuar në vetëm 30 minuta presidentin, kryeministrin, ministrin e Jashtëm dhe të Mbrojtjes, pra katër zyrtarët kryesorë për situatën e asaj periudhe. Evitimi i takimit me Parlamentin dhe takimi shkurt për zyrtarët e lartë ishte sinjal se nuk priteshin diskutime partneriteti dhe as strategjike, por formale. Kjo krijoi shqetësim në qeveri, ku krahas habisë për kohën e caktuar dhe zgjedhjen për takim të përbashkët të presidentit me kryeministrin, u tha se “*ne quhemi Republikë Parlamentare*.”⁵³

Qeveria e re e drejtuar nga Pandeli Majko solli uljen e tensioneve në Tiranë dhe midis saj e Prishtinës, por pa arritur nivelin e bashkëpunimit që ishte shënuar në fillimet e viteve të ‘90-ta dhe që do të shënohej pas viteve 1999-2000. Ndryshe nga Nano, i cili në kërkim të protagonizmit individual ndërmori edhe akte që rezultuan të gabuara, Majko ishte më pragmatist dhe modest në qasje dhe synime, më bashkëpunëtorë dhe më i hapur për konsultime të shumëfishta, përfshirë me opozitën brenda apo faktorë politikë në Kosovë. I ndërgjegjshëm për dobësinë e qeverisjes së tij dhe kapaciteteve shtetërore ai bëri përpjekje jo të vogla për t’i kompensuar ato me retorikë patriotike dhe akte politike solidarizuese.

⁵² International Crisis Group (ICG 2000). Balkans Report N° 87, Albania: State of the Nation, 1.3.2000, 5.

⁵³ AQSH. F.490, V.1999, D.414. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 11.5.1999, 5.

Nga mbledhjet e qeverisë të periudhës mars-maj 1999 rezulton se Majko ishte anëtar i interesuar dhe më i lexueshëm i kabinetit për zgjidhje me çdo kusht të problemeve të krijuara, ndërkohë që në kabinetin e tij kishte ministra, të cilët nuk e vlerësonin dhe as e ndiqnin situatën me seriozitetin dhe përgjegjësinë që kërkohej. Për shembull, me të drejtë kryeministri shfaqti kritika ndaj vonesave, pengesave apo mosmbajtjen e premtimeve nga ministrat e Financës, të Shëndetësisë, të Pushtetit Vendor, të Transportit etj. Nga ana tjetër, në qasjen e kryeministrit dhe shumicës së ministrave të tij, kryesisht ministrave pa përvojë të mëparshme, kishte më shumë nota populiste dhe emocionale sesa qasje ligjore dhe administrative.

Në disa prej mbledhjeve propozimet hidheshin poshtë për shkak të referencës së gabuar ligjore apo mosnjohjes së kompetencave, si dhe disa të tjera edhe nga niveli utopik i tyre që i bënte automatikisht të perealizueshme. Për shembull ideja e urdhrave për marrjen apriori në përdorim nga shteti të mjeteve private të transportit, për përdorimin e ushtrisë në shërbime policore, për diktim të zonave për ngritjen e kampeve, për përdorim të fondeve të buxhetit pa akte mbështetëse ligjore, deri edhe për kalimin e përgjegjësisë së menaxhimit të ndihmave nga autoritetet ndërkombëtare te Qeveria, ishin disa prej rasteve të pabazuara që u refuzuan.

Mangësitë, mungesa e përvojës dhe kapacitetet e kufizuara dolën në pah gjatë fundit të muajit mars dhe deri në fundin e muajit maj 1999, gjatë periudhës së luftës dhe krizës së refugjatëve. Më 22 mars një mbledhje urgjente qeverie e kompletonte këtë pamje. Fillimisht ministri i Jashtëm, Milo, sugjeroi në mbledhjen e Qeverisë se *“ne në të gjitha masat që marrim nuk duhet të themi me që jemi duke u përgatitur, por ne duhet të themi që ne jemi plotësisht të përgatitur, sepse nuk duhet t’ia lëmë momentit të fundit”*⁵⁴, si dhe rekomandoi masa ligjore në mbështetje të kërkesave të nevojshme nga Ministria e Mbrojtjes. Kjo e fundit ofroi garanci për gjendjen e ushtrisë pasi

⁵⁴ AQSH. F.490, V.1999, D.262. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 24.3.1999, 5.

“ushtria po kompletohet dita-ditës me gjithë arsenalin e nevojshëm të armatimit, të teknikës luftarake, me kontingjente”, se “kemi marrë edhe 500 ushtarë me pagesë”, “kemi zhvilluar një stërvitje në Shkodër, ku demonstruam në teknikë dhe në armatim”, si dhe duke filluar nga data 1 prill, i gjithë Divizioni i Kukësit do të jetë në gjendje gatishmërie të lartë⁵⁵.

Në fakt lufta nisi 48 orë më vonë dhe me nisjen, strukturat ishin dukshëm të vonuara në reagimin e tyre. Në mbledhje u kalua debati te proceset gjyqësore dhe lirimi nga gjykatat të një prej figurave kryesore të krimit në Vlorën e vitit 1997. Për Qeverinë vendimi ishte akt sabotimi nga drejtësia, drejtuesit e së cilës ishin emëruar nga e njëjta mazhorancë. Ministri Milo tha në Qeveri se *“nga njëra anë kërkohen zgjedhje të parakohshme, nga ana tjetër lirohen bandat, kjo nuk është rastësi, diku një dorë i lidh këto gjëra, për të destabilizuar këtë vend”⁵⁶*, një deklaratë e cila shpreh konceptin e gabuar politik të kohës, sipas të cilës, kërkesat politike kundër qeverisë apo aktet e institucioneve të pavarura shiheshin si akte armiqësore me sponsorizim nga jashtë.

Nga diskutimi rezulton se Qeveria shqetësohej për kostot politike që duhej të paguante për vendimet e drejtësisë, si dhe për brishtësinë e mbështetjes së saj publike, ndaj edhe akuzat e skajshme kanë më shumë përmbajtje emotive momenti sesa racionalitet apo argumente. Ky tipar do të shfaqej gjatë gjithë kësaj periudhe, sa më e dobët dhe më nën presion Qeveria aq më shumë shtoheshin debatet në mbledhjet e Qeverisë kundër opozitës politike dhe kritikëve. Zgjidhja e artikuluar nga ministri i Kulturës, Edi Rama, ishte një sistem i ri propagande aktive, puna me median, si dhe kërkesa që komuniteti

⁵⁵ AQSH. F.490, V.1999, D.262. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 24.3.1999, 3.

⁵⁶ AQSH. F.490, V.1999, D.262. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 22.3.1999, 7.

ndërkombëtar të ushtrisë presion mbi opozitën për të hequr dorë nga kërkesat apo aktet e saj politike.⁵⁷

Një nga shqetësimet e vazhdueshme të ministrave ishte mungesa e informacionit sistematik për vetë kabinetin dhe deputetët. Në mbledhjen e Qeverisë më 22 mars ministrja Meksi tha se në takim me një delegacion suedez kur u pyet lidhur me zhvillimet e fundit në Kosovë *“si anëtare e kabinetit e ndjeva veten bosh”*.⁵⁸ Të njëjtat shqetësime u përsëritën disa herë, madje në mbledhjen e Qeverisë më 11 maj ministri për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Arben Imami kërkoi *“një informacion më diskrecion, jo çdo informacion që keni ju zoti Kryeministër, na është i nevojshëm, d.m.th. të jeni i sigurt se gjysmën e kohës e kaloj në kompjuter duke kërkuar se çfarë po del p.sh. te "Zëri Kosova", sepse nuk marrim informacion tjetër”*.⁵⁹ Disa rivalitete dolën në pah, kryesisht midis ministrit të Jashtëm Milo, i cili vinte nga partitë aleate të koalicionit dhe zv/kryeministrit Meta dhe Sekretarit të Shtetit, Lakrori, të dy funksionarë të lartë të PS-së.

Për shembull, më 11 maj në mbledhjen e Qeverisë ministri Milo deklaroi me shqetësim se është informuar vetëm nga gazetatat se të nesërmen vjen në Tiranë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Havier Solana.⁶⁰ Të njëjtat ankesa ai pati për disa vizita të tjera ndërkombëtare dhe qëndrime, të cilat sipas tij nuk ishin të koordinuara. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Qeveria nuk pati një sistem informimi institucional për ministrat dhe deputetët dhe as për strukturat administrative. Marrëdhëniet u ndërtuan kryesisht në linjë personale dhe hierarkike, dhe se kjo erdhi sa nga

⁵⁷ AQSH. F.490, V.1999, D.262. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 24.3.1999, 49.

⁵⁸ AQSH. F.490, V.1999, D.262. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 18.

⁵⁹ AQSH. F.490, V.1999, D.414. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 12.

⁶⁰ AQSH. F.490, V.1999, D.414. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

zhvillimet e shumta nën presion e kohë të shkurtër aq edhe nga nevoja e drejtuesve politikë për të përfituar sa më shumë kredenciale publike dhe sidomos nga partnerët ndërkombëtarë.

Në mbledhjen e Qeverisë më 23 mars Qeveria diskutoi mbi *“skenarin e reprezaljeve ndaj Shqipërisë”* e bindur se *“ky skenar ekziston si moment, pra që mund të kemi reprezalje ndaj Shqipërisë dhe sidomos karshi Tiranës, që do të thotë edhe karshi institucioneve përkatëse kryesore të funksionimit të shtetit, me qëllim që të ketë edhe një moment moskoheracioni me situatën në kufi”*.

Krahas Tiranës Qeveria i frikësohej situatës në Shkodër ndaj urdhëroi marrjen në mbrojtje të institucioneve nga trupat komando. Nga ana tjetër kryeministri kërkoi që i gjithë brezi që fillon në Shkodër vazhdon në Malësinë e Madhe, me Tropojën, Kukës, Has, duhet të jetë një brez, i cili në konceptim policor dhe ushtarak duhet të jetë në gatishmërinë përkatëse. Porosia e kryeministrit u kundërshtua nga Ministria e Mbrojtjes, me argumentin se *“trupat komando dalin në situata të veçanta, kur ka veprime terroriste, ndërsa në kohë lufte trupat komando shkojnë në front, nuk ruajnë institucionet, këto janë trupa speciale të përgatitura vetëm për këto veprime, nuk janë rojë”*.

Kur më 24 mars kryeministri informoi Qeverinë për bisedën me Solanën dhe pritshmërinë për nisjen e sulmeve ushtarake, akti i parë i Qeverisë ishte sigurimi i “anëtarëve të Parlamentit “për të cilët në momentin aktual duhet të sigurohen mjetet edhe për t’u evakuuar ose në Chateau Linza ose në një vend larg Tiranës, ku nuk është i goditshim”.⁶¹ Masa e dytë sipas kryeministrit është përgatitja e akteve ligjore për shpalljen e gjendjes së mobilizimit, *“minimalisht ne duhet ta shpallim në zonën e Veriut”*. Masa e tretë të shpallet gatishmëria e ushtrisë për mbrojtjen kundërajrore të Tiranës. Së katërti, përgatitja e aktit për mobilizim të përgjithshëm dhe prekja e rezervës financiare për momentin përkatës. Ministri i Financave, Angjeli, kërkon edhe mbrojtjen e rezervave financiare të shtetit, Bankës dhe sidomos

⁶¹ AQSH. F.490, V.1999, D.414. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

mbrojtjen e Qeverisë “*në këtë situatë kjo Qeveri duhet mbrojtur*”. Diskutimi se ku dhe si do të strehën deputetët apo ministrat, stafi i kabineteve apo sesi do të komunikohet mes tyre mori pjesën më të madhe të diskutimit në mbledhje. Ministrat nuk ishin të qartë nëse Shqipëria duhet të shpallë gjendje lufte ose të jashtëzakonshme dhe midis njëri-tjetrit, përfshirë ministrin e Kulturës, Edi Rama, pati debat lidhur me planin e vendstrehimeve, sigurinë e Parlamentit dhe formën e komunikimit midis ministrive. I lexuar në retrospektivë ky debat duket surrealist dhe në kontrast me emergjencat e kohës kur bëhej, megjithatë është një tregues domethënës për gjendjen dhe prioritetet.

Në njërën prej mbledhjeve të shumta të datës 24 mars ministri i Brendshëm, Petro Koci, raportoi se strukturat tona të policisë kufitare janë insuficiencë në numër, ndaj kërkoi marrjen në detyrë të ushtarëve kundrejt pagesës. Qeveria gjithashtu vendosi prokurim të furnizimit me 15 mijë këpucë të ushtarakëve. Gjatë debatit për këtë, zyrtari përgjegjës në Ministrinë e Mbrojtjes, Kiço Kalaja, informoi se aktualisht “kemi gjysmën e oficerëve pa këpucë” dhe që ndaj përdorin këpucë civile, si dhe nuk kanë uniforma të reja të njësuara. Më 26 mars Qeveria u mbledh shkurtimisht për të diskutuar lidhur me furnizimin me ushqime të zonave veriore. Ministri i Bujqësisë, Lefter Xhuveli, informoi se ka dërguar të gjithë kapacitetet e rezervave të shtetit, ndërkohë që deri në atë moment kishin kaluar kufirin vetëm disa qindra qytetarë nga Kosova.

Pas mbledhjeve të shumta, deklarimeve për masa dhe kapacitete mbledhja e Qeverisë më 27 mars nxori në pah hendekun e thellë midis deklarimeve dhe realitetit. Kryeministri Majko përdori një gjuhë të ashpër kundër ministrave, të cilët kishin deklaruar masa dhe dhënë garanci, të cilat nga verifikimet e tij në terren nuk ekzistonin. Ai citoi mungesën e furnizimeve me ushqime dhe ilaçe në Kukës e Has duke thënë se garancitë e dhëna nga ministrat rezultuan të papërmbushura. Një problematikë tjetër lidhej me kapacitetet pritëse. Deklarimet e ministrisë së Pushtetit Vendor për rreth 15 mijë vende pritëse, rezultuan larg realitetit, pasi numri i tyre sipas standardeve të UNHCR-së ishin më pak se gjysma. Ministri i Jashtëm, Milo, deklaroi

në mbledhje se «*duket se jemi të papërgatitur për t'u përballuar ky fenomen, për të cilin kemi folur 10 ditë rresht*» duke sjellë rastin e kritikave të UNHCR-së, se pala shqiptare nuk ka dhënë përgjigje për disa kërkesa të tyre për terrene kampesh apo disa terrene të ofruara janë të papërshtatshme. Të njëjtën deklaratë përsëriti edhe kryeministri Majko, i cili solli si emergjencë nevojën e përgatitjes së terreneve për vendosjen e kampeve nga organizatat ndërkombëtare. Pikërisht më 27 mars, në kulmin e krizës, ministri i Financave, Angjeli, propozoi rikrijimin e strukturave që u përdorën një vit më parë me 20 mijë refugjatët e ardhur. Akuzat reciproke midis ministrave lidhur me vonesën disamujore në marrjen e masave apo mungesën e rezultateve konkrete.

Pikërisht më 28 mars, pra në kulmin e krizës, Qeveria mori vendim për Krijimin e Komisionit Qeveritar për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova, strukturë që duhej të ishte ngritur muaj më parë. Nga puna e Komisionit dhe të dhënat e ministrave u konfirmuan edhe problematika të hendeikut midis ndihmave të deklaruara dhe të atyre reale. Për shembull, ministri i Shëndetësisë informoi Qeverinë më 3 prill se nga 6 maune të ardhura nga shoqata “Mjekët e Botës” vetëm një pakicë e vogël ishin medikamente, pjesa kryesore ishin batanije e çadra, pra pajisje mbështetëse. Po ashtu, nga 80 ambulanca të deklaruara *de facto* ato nuk ishin të tilla, por mjete pune për personelin, të cilat me largimin e tyre do t'i marrin me vete.⁶²

Më 29 mars në Kuvend gjatë debatit për situatën në Kosovë dhe valën e refugjatëve opozita kërkoi ndërprerjen e marrëdhënieve me Serbinë.⁶³ Kërkesa u përsërit disa herë nga media dhe politikanë, përfshirë të mazhorancës, por Qeveria bëri përpjekje për t'iu shmangur reagimit. Më 2 prill Qeveria shprehu shqetësimin se vendimi i NATO-s për ndalimin e fluturimeve të tjera në territorin

⁶² AQSH. F.490, V.1999, D.289. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 3.4.1999, 76.

⁶³ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 29.03.1999, 300.

shqiptar përveç atyre ushtarake të vet Aleancës kishte krijuar pengesa dhe vonesa në shpërndarjen e ndihmës humanitare sidomos në zonat veriore ku largësia dhe infrastruktura e vjetër krijonte vështirësi të mëdha.⁶⁴ Më 7 prill, Kuvendi miratoi ligjin “Për pranimin e një force ushtarake të NATO-s, në mbështetje të operacioneve ushtarake në rajon”, akt për të cilin presidenti e dha miratimin paraprak për të hyrë menjëherë në fuqi.

Reflektimet e munguara për menaxhimin politik dhe teknik

Kuvendi ngriti më 1998 një Komision të Posaçëm parlamentar Ad-Hoc për mbikëqyrjen e zbatimit të programit për plotësimin e nevojave të refugjatëve nga Kosova, të drejtuar nga deputeti Jonuz Begaj. Komisioni ishte aktiv në vizita dhe raportime, por në përgjithësi puna e tij u kritikua shpeshherë në Parlament nga vetë mazhoranca për pasaktësi, formalitet dhe mungesë qartësie dhe strategjie.⁶⁵ Komisioni nuk arriti të prodhojë dokumente dhe rekomandime efektive, megjithëse duke vepruar në një parlament pa opozitë kishte akses të pakufizuar.

Kuvendi miratoi disa rezoluta, por deputetët në përgjithësi nuk kishin informacione të plota mbi situatën dhe as debatet politike nuk çuan në ndonjë akt zyrtar me ndikim në ecurinë e zgjidhjes së krizës. Kur refugjatët e parë kaluan në Shqipëri më 24 mars në kufirin verilindor mes Kosovës dhe prefekturës së Kukësit, përgjigjja politike e Qeverisë ishte e paqartë.⁶⁶ Për të përballuar kostot e krizës, Parlamenti miratoi shpejt një buxhet emergjent që rialokoi fondet për ministrinë më të përfshira, duke përfshirë shëndetësinë, transportin, arsimin, rendin publik, punët publike dhe qeverisjen vendore. Rritja e paralajmëruar e pagave për punonjësit publikë u vonua pa protesta nga punëtorët.

⁶⁴ AQSH. F.490, V.1999, D.261. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, 02.04.1999, 61.

⁶⁵ Kuvendi i RSH. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 375-376.

⁶⁶ Kosta Barjaba. (2000). Social impacts of the Kosovar refugee crisis in Albania. The World Bank, 2.

Kuvendi nuk ishte i vetmi. Dobësi, vonesa dhe problematika shfaqën edhe organizmat ndërkombëtarë. Në dhjetor 1998, UNHCR-ja parashikonte se do të kishte ardhje refugjatësh nga Kosova në drejtim të Shqipërisë, por në çdo rast në shifra jashtëzakonisht shumë më të vogla sesa ato që u arritën realisht. Kështu UNHCR-ja llogariste se mund të ketë rreth 5 mijë refugjatë nga Kosova gjatë 6 muajve të parë të vitit 1999 dhe në total gjatë gjithë vitit maksimumi 25 000 refugjatë nga Kosova dhe vende të treta.⁶⁷ Deri në fund të majit 1999, rreth 450 000 refugjatë kosovarë e rritën popullsinë shqiptare prej 3.4 milionë banorësh me rreth 14%.⁶⁸

Komuniteti humanitar ishte i papërgatitur për skenarin e spastrimit gjithëpërfshirës etnik që pasoi fushatën e NATO-s. Shumica e 150 organizatave ndërkombëtare filluan programet vetëm në prill dhe maj. Vetëm në fundin e muajit maj u bë e qartë se UNHCR-ja duhej të rikthehej në një rol udhëheqës për të mbushur “vakumin e koordinimit”.⁶⁹ Në tërësi, operacioni humanitar nga fundi i marsit 1999 u dëshmuua të jetë po aq i politizuar, i vështirë dhe një operacion kompleks siç është përballur ndonjëherë nga agjencitë humanitare të OKB-së pjesëmarrëse. Një mori problemesh të mbrojtjes, logjistikës dhe koordinimit duhej të trajtoheshin në një mjedis të ngarkuar politik dhe të sigurisë. Shumë mësimë tashmë janë nxjerrë dhe UNHCR-ja urdhëroi një vlerësim të pavarur, “*i cili filloi në fillim të korrikut, për të siguruar që të nxirren të gjitha mësimet e duhura*”.⁷⁰

Krizat e njëjta do duhej të shoqëroheshin me databazë të dhënash dhe aktesh, të nevojshme për analiza më të thelluara dhe krahasuese. Këto dy elementë i munguan rastit shqiptar të vitit 1998-

⁶⁷ UNHCR Global Appeal 1999 - Albania, 1 December 1998.

<https://www.unhcr.org/publications/unhcr-global-appeal-1999-albania>

⁶⁸ Koenraad Van Brabant (1999). RRN Coordinator, London, Albania (June 1999), Issue 14, 24-24, Relief and Rehabilitation Network, - Article 16.

⁶⁹ UNHCR Global Appeal 1999 - Albania, 1 December 1998

<https://www.unhcr.org/publications/unhcr-global-appeal-1999-albania>

⁷⁰ United Nations, Revision of the 1999 United Nations Consolidated Inter-Agency Appeal for the Southeastern Europe Humanitarian Operation, July 1999.

1999. Ilustrim ishte debati e të dhënat mbi ndarjen midis kontributit të shtetit dhe të individëve (banesat private). Të dhënat ndryshojnë nga burime të ndryshme, por në thelb, kontributi privat mbetet dominues. Kështu, revista “Newsweek International” më 30 maj 1999 raportonte se vetëm 10% e refugjatëve jetojnë në kampe; pjesa më e madhe e tyre janë strehuar me familje pritëse, duke e konsideruar këtë një arritje të jashtëzakonshme nga ana e një kombi të vogël dhe që renditet si më i varfëri në Evropë.⁷¹ UNHCR-ja raportoi pas krizës se rreth 68% e refugjatëve janë pranuar nga familjet pritëse ose kanë gjetur strehimin e tyre; pjesa tjetër jeton në kampe me tenda ose qendra kolektive.⁷²

Ndërkohë në një debat parlamentar në mesin e muajit prill 1999, zv/kryeministri Meta deklaroi në Parlament se *“120 mijë të ardhur janë sistemuar nëpër shtëpitë e qytetarëve të ndryshëm dhe mund të them se pa këtë mikpritje dhe këtë bujari të tyre kjo krizë monetare do të ishte shndërruar në një katastrofë humanitare që në fillimet e saj”*.⁷³ Në të njëjtin debat ministri i Pushtetit Vendor, Arben Demeti, raportoi në Parlament se nëse do të llogaritim që, përveç 145 mijë njerëzve që janë sistemuar në rrethet pritëse të Shqipërisë, janë dhe mbi 80 mijë njerëz të tjerë të sistemuar në familjet pritëse kuksjane në prefekturën e Kukësit, Hasit dhe Tropojës, numri i tyre shkon mbi 225 mijë veta të sistemuar sot në familjet shqiptare.⁷⁴ Me këtë rast ministri bëri përgjegjëse vonesën e ndihmave nga jashtë, përsëri nevojat mbeten më të mëdha në raport me prurjet e ndihmave, dhe se ndaj, *“barra më e madhe u ka rënë familjeve pritëse. Në javët e para, në familjet pritëse nuk shkoi asnjë gjë nga ndihmat që po vijjnë”*.⁷⁵

⁷¹ Intervistë me Rexhep Meidani (1999). Shelter For The Refugees, Newsweek International, May 31, 1999 (<https://www.newsweek.com/shelter-refugees-166556>)

⁷² Koenraad Van Brabant (1999). RRN Coordinator, London, Albania (June 1999), Issue 14, 24-24, Relief and Rehabilitation Network, - Article 16.

⁷³ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 382-383.

⁷⁴ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 400.

⁷⁵ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 401.

Në administrimin e ndihmave u krijua një konflikt i fortë midis Qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare, sidomos UNHCR-së. Shtetet e ndryshme i kaluan ndihmat përmes UNHCR-së, duke mënjeluar përfshirjen e Qeverisë, kryesisht për shkak të ekspertizës dhe përvojës së organizatës ndërkombëtare në misione të tilla. Gjatë raportimeve në Parlament dhe në publik Qeveria u ndje nën presion dhe kritika për situatën e ndihmave ndërkohë që ajo e përjashtoi vetën nga përgjegjësia e administrimit të tyre.

Në fundin e muajit mars Qeveria i kërkoi agjencive të OKB-së që menaxhimin *“ta bëjnë vetëm me shtetin, se kjo është një punë që duhet centralizuar, në mënyrë që të ketë sukses dhe të bëhet shpejt”*.⁷⁶ Kërkesa u refuzua dhe Qeveria u la jashtë sistemit të administrimit të ndihmave. Një numër incidentesh ndodhën, për shembull, kur zv/kryeministri Meta informoi Qeverinë më 28 mars se kapacitetet e deklaruara pritëse janë larg pritshmërive duke sjellë rastin e Durrësit, i cili ndonëse deklaroi gatishmëri për 2 mijë të strehuar, ndërkohë që rezultoi se nuk kishte pajisje bazë si *krevatet apo dyshekët*.⁷⁷

Në Parlament mazhoranca shprehu shqetësimin se *“Qeveria ka dalë jashtë loje”* dhe se *“të jepet përshtypja se ka një kaos të plotë në këtë drejtim. Nga media të jepet përshtypja se ndihmat janë lumë, nga deti dhe nga ajri, nga të gjitha drejtimet, por kush i orienton këto?”*.⁷⁸ Sipas raportimit të Komisionit Ad-Hoc në Parlament, UNHCR-ja mori përsipër vetëm regjistrimin dhe pajisjen me të gjitha obligimet ndaj atyre të ardhurve të deportuarve kosovarë të cilët janë strehuar nëpër familje, kurse detyrat e tjera për ushqimin e tyre, qoftë nëpër kampingje, qoftë nëpër këto vendstrehime që janë krijuar në këto ish-ndërmarrjet e ndryshme, nëpër reparte ushtarake i ka marrë Fondi Botëror i Ushqimit.⁷⁹

⁷⁶ AQSH. F.490, V.1999, D.289. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 28.03.1999, 16.

⁷⁷ AQSH. F.490, V.1999, D.289. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 28.03.1999, 25.

⁷⁸ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 377.

⁷⁹ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 379.

Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, Kadri Rrapi, informoi në Parlament se “nga Qeveria menaxhohen në peshë 8,7 % e ndihmave dhe nga organizatat joqeveritare 91,3 % e tyre. Në vlerë, në total 15,44 % nga Qeveria dhe 84,56 % nga organizatat joqeveritare. Strukturat e krijuara pranë Qeverisë për menaxhimin e krizës kanë për detyrë pikërisht koordinimin e ndihmës, por shteti nuk mund të ndërhyjë në kompetencat e OJQ-ve”.⁸⁰

Qeveria konfirmoi në Parlament se për shumë probleme i ka bërë presion vazhdimisht jo vetëm UNHCR-së, organizatave të tjera dhe OJQ-ve që të jenë më transparente, të koordinojnë më mirë me Qeverinë shqiptare në qendër, por edhe prefekturave, pra shtabeve në prefektura, këshillave në rrethe në mënyrë që ndihma të mos shpërdorohet, por të shkojë atje ku ajo duhet.⁸¹ Lidhur me transparencën, Qeveria konfirmoi se kryeministri ka kërkuar ndihmën e të gjitha organeve të specializuara për t’u angazhuar në këtë drejtim.

Akuzat dhe dyshimet mbi shpërdorimin e ndihmave e detyruan Qeverinë të diskutonte më 2 prill nevojën për hetime nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Prokuroria, si dhe mundësinë për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar.⁸² Nisma ra për shkak se ende nuk kishin nisur shpërndarja e ndihmave dhe kryesisht për shkak të ngarkesës politike të nismës, e cila ishte edhe kërkesë e opozitës. Në ditët vijuese pati raportime në media dhe deklarime publike për raste të dyshuara abuzuese. Akuzat përfshinin organizata joqeveritare, kryesisht ato të krijuara rishtas gjatë krizës, zyrtarë përgjegjës lokalë, zyrtarë të sigurisë dhe të tjerë në nivelin e administrimit qendror dhe lokal. Për pasojë, më 19 prill Parlamenti debatoi mbi kërkesën e deputetëve të Kukësit dhe rekomandimin e komisionit të posaçëm për përfshirjen e KLSH-së dhe të Prokurorisë në hetimin e çdo raporti mbi abuzimet me ndihmat humanitare për të vendosur para drejtësisë

⁸⁰ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 22.04.1999, 404.

⁸¹ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 382-383.

⁸² AQSH. F.490, V.1999, D.289. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 02.04.1999, 69.

individët që kanë abuzuar.⁸³

As Qeveria, as Kuvendi dhe as Prokuroria nuk arritën të krijojnë strukturë hetimore, pasi me mbarimin e luftës historia e menaxhimit të krizës u konsiderua politikisht si histori suksesi. Hetimi do ta cenonte këtë përcaktim. Të ndërgjegjshëm për problematikat dhe natyrën eksperimentale të menaxhimit të krizës kryeministri Majko dhe zv/kryeministri Meta shpallën në mbledhjen e Qeverisë më 23 prill nismën *“për të bërë një analizë të këtij muaji që ka kaluar, se si e kemi përballuar dhe si do ta përballojmë në të ardhmen dhe të kemi të qartë një strategji të Qeverisë sonë, në kuptimin e asaj që për sa kohë do të përgatitemi, si i kemi bërë llogaritë, që të dimë se sa ndihma kanë ardhur deri tani, sa kanë ardhur në vlerë, sa kanë ardhur ndihma në mallra”,* pra *“të gjithë formatin ligjor të menaxhimit të krizës, urdhrat e të gjitha nga fillimi deri në fund”*.⁸⁴ Kjo analizë nuk rezultoi të jetë bërë në këtë formë, gjithsesi fakti që ata e kërkuan do të thotë se ajo ishte mëse e nevojshme.

Edhe faza fundore, ajo për kthimin e të deportuarve në Kosovë pas qershorit 1999 u shoqërua me problematika dhe spontanitet. Një raport i EMG-së⁸⁵ dëshmon se deri më 9 korrik ishin kthyer 84.5% e refugjatëve të zhvendosur në Shqipëri dhe vendet e tjera fqinje me Kosovën. Shteti shqiptar në koordinim me agjencitë ndërkombëtare organizoi rikthimin me autobusë, tren, helikopterë dhe avionë, por një raport i ekspertëve të NATO-s më 12 korrik tregoi se refugjatët gjenin rrugë personale rikthimi dhe se më 10 korrik në Elbasan vetëm 42 persona shfaqën interes të udhëtonin në një tren me kapacitet prej 400 vendesh, ndërkohë që një javë më parë ishin së paku 300 persona që udhëtonin.

⁸³ Kuvendi i RSH-së. Viti 1999, Legjislatura e 15-të, 19.04.1999, 374.

⁸⁴ AQSH. F.490, V.1999, D. 380. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 23. 04.1999, 3-4.

⁸⁵ Emergency Management Group (1999). EMG - Situation Report - 12 Jul 1999. (<https://reliefweb.int/report/albania/emergency-management-group-situation-report-12-jul-1999>)

Raporti vlerësonte se mungesa e informacionit për qytetarët e interesuar për kthim ashtu edhe pamundësi kontakti me ta, për shkak se ishin vendosur kryesisht në banesat private të shtetasve të Shqipërisë. Misioni i NATO-s theksoi se disa refugjatë që kërkuan riatdhesim nuk dinin detaje të planit të organizuar dhe as këtu për të kërkuar më shumë informacion dhe se një pjesë e rasteve dukej se nuk ishte në dispozicion të transportit të organizuar dhe falas. Me synimin për të maksimizuar përdorimin e transportit të rregullt, EMG-së dhe UNHCR-së përgatitën dhe shpërndanë në Durrës, Elbasan, Fier dhe Tiranë një fletushkë dhe poster që tregon disponueshmërinë e transportit dhe rendit oraret e rregullta të nisjes së trenave. Po ashtu, kampet e refugjatëve dhe të administrimit të ndihmave u përballen edhe me kërcënime të sigurisë së brendshme.

Në një raport të EMG -së mbi gjendjen në kampet në Shkodër dhe Mjedë ilustruhet rasti kur më 11 korrik kishte pasur kërcënime ndaj punonjësve të ndihmës humanitare. Më 9 korrik ushtria austriake iu përgjigj zjarrit nga sulmuesit e panjohur duke plagosur 2 persona. Hetimi më vonë zbuloi se në një mosmarrëveshje të armatosur mes palëve lokale, njëra palë ka qëlluar në drejtim të kampit. Lajme të tilla për incidente, raste të dyshuara për grabitje dhe keqkuptime midis forcave të huaja ushtarake e civile me komunitetet vendore, lëvizje e qytetarëve me mjetet dhe njohjet e veta personale etj., ishin të shumta gjatë gjithë muajit qershor dhe korrik 1999.

Krahas historisë dramatike të pasojave të luftës, viti 1999 shënoi edhe ritakimin e shumëfishtë të Shqipërisë me Kosovën, si dhe testoi kontaktet intensive në nivelet midis qytetarëve, aktorëve politikë dhe atyre institucionalë. Situata e paprecedentë, në të cilën sipas kalkulimeve të ish ministrit të Kulturës, Edi Rama, *“në 2.5 sekonda hyn një kosovar në Shqipëri dhe sikur kjo t’i kishte ndodhur Italisë do të kishin hyrë 2.5 milionë sicilianë”*,⁸⁶ vuri në sprovë të jashtëzakonshme Shqipërinë, një prej shteteve më të dobëta në zonën

⁸⁶ AQSH. F.490, V.1999, D.289. Procesverbal mbi mbledhjen e Këshillit të Ministrave, 02.04.1999, 68.

evropiane.

Kadare përdori shprehjen “ra ky mort dhe u pamë”, ndërsa një qytetar i deportuar nga Kosova që erdhi për herë të parë në Shqipërinë e vitit 1999 i pati deklaruar medias se *“ne në Kosovë kemi pasur një imazh të Shqipërisë kopsht me lule, rregull e pastërti, pasuri, shtet model. Ne e mendonim Shqipërinë si një shtet model ideal. Dhe në vitin 1999, Kosova pa një tjetër Shqipëri. Gjatë viteve të ‘90-ta ka pasur shkëmbime njerëzish, informacionesh, dhe ne kuptuam që Shqipëria nuk ishte kopsht me lule, por këto ishin shkrime gazetash dhe histori të rralla individuale”*.⁸⁷

Shqipëria e viteve 1997-1999 ishte ende një shtet i brishtë, më shumë deklarativ sesa funksional, i dominuar nga konfliktet e brendshme politike dhe mungesa e stabilitetit, por edhe një shtet që ndjen peshën e madhe të momentit historik. Një pjesë e madhe e zyrtarëve, përfshirë politikanë apo zyrtarë administrativë, si dhe shumica qytetarë, u përpoqën të bëjnë më të mirën në situatë të jashtëzakonshme dhe se lufta në Kosovë me valën e refugjatëve ndryshoi pothuajse gjithçka në perceptimin reciprok dhe në bazën e raporteve për të ardhmen. Vitet 1998-1999 u shoqëruan me ndryshim të kursit politik në Tiranë dhe Prishtinë, ndryshim të situatës në Ballkan dhe të përfshirjes së Perëndimit në Evropën Juglindore, si dhe në aspektin lokal, ndryshime në lidhshmëri, në përfaqësim dhe në konceptet e organizimit shtetëror.

Në mesin e dy krizave Shqipëria miratoi Kushtetutën e parë të sistemit të ri, në qershor 1999 Kosova nisi fazën tranzitore drejt shtetkrijimit dhe Pavarësisë. Më 1999 një sondazh britanik me refugjatët zbuloi se vetëm 50% e tyre kërkonin bashkimin me Shqipërinë dhe megjithatë 89.4% besonin se Shqipëria kishte një rol për të luajtur në të ardhmen e Kosovës, pa e përcaktuar atë.⁸⁸

⁸⁷ Intervistë me Abaz Osmanin (2024). Refugjati i luftës nga Kosova: Ne e dinim Shqipërinë kopsht me lule, por vetëm në 1999 u njohëm realisht, kur hapët dyert për ne, gazeta *Shqiptarja*, 02.07.2024.

⁸⁸ British Foreign and Commonwealth Office (FCO 1999). Kosovar Refugees in Albania Poll, September 1999.

Krahas detyrimeve dhe përgjegjësive të tjera Shqipëria kishte edhe një detyrim kushtetues. Sa arriti ajo ta përmbushë këtë rol, sa e zgjodhi atë dhe cilat ishin kapacitetet dhe mundësitë? A kishte zgjidhje të tjera alternative? Duke supozuar se Shqipëria do të ishte në rrethanat e shtetit më funksional, më demokratik, më të fortë ushtarakisht dhe më me imazh pozitiv ndërkombëtar, cili do të mund të kishte qenë roli dhe pozicioni i saj në rastin e viteve 1998-1999 në Kosovë? Nga hulumtimet e thelluara arkivore shqiptare dhe përfundime, shumica të cituara në këtë punim, krijohet bindja se në të gjitha rastet e rrethanat Përfundimi do ta përjashtonte Shqipërinë si aktor të mundshëm ndikues, kryesisht për shkak të interesit të saj të njëanshëm kombëtar në konflikt dhe riskut të përhapjes së konfliktit.

Edhe në Shqipëria do të kërkonte një rol aktiv, fokusi i saj do të kufizohej vetëm te menaxhimi i krizës së të ardhurave, jo në aspektin ushtarak dhe gjeopolitik. Vlerësimi vlen pavarësisht se cila parti ose qeveri ishte në pushtet. Nga ana tjetër, një Shqipëri më funksionale dhe më e aftë do të kishte pasur rol shumë më aktiv, më strategjik dhe efektiv në administrimin e hershëm dhe të qëndrueshëm të krizës humanitare dhe impaktit të saj brenda vendit. Fakti se ajo e përmbushi këtë rol vetëm pjesërisht i dedikohet kryesisht gjendjes së saj, mangësive dhe përgjegjësive në drejtimin dhe menaxhimin e shtetit. Në një situatë hipotetike mund të merrej në konsideratë edhe mundësia e një qeverie kombëtare koalicioni të gjerë, midis PS-së dhe PD-së, e ngjashme si ajo më 1991 apo 1997. Mosmarrja në konsideratë e këtij opsioni lidhej sa me hendekun e thellë në përfaqësimin politik midis dy palëve dhe interesin e shumicës për të menaxhuar situatën edhe në aspektin e kredencialeve politike elektorale, por edhe me konfliktin e rënduar nga arrestimet politike, protestat e vazhdueshme, bojkoti dhe abuzimi sa me pushtetin e pakufizuar aq edhe me hapësirën publike.

Fakti se palët politike u dakorduan me sloganin “*një komb-një qëndrim*” ishte më shumë simbolik sesa realist pasi nuk pati efekt në politikën, aktet dhe vendimmarrjet shtetërore që shoqëruan atë. Reagimi “si komb” nuk ndodhi në aspektin e rezistencës në luftë, por

ndodhi në aspektin humanitar. Teza se Shqipëria politike kishte konsensus të gjerë lidhur me zhvillimet në Kosovë gjithashtu duhej marrë me rezerva. Të gjitha partitë ishin pro Kosovës dhe pro ndërhyrjes së NATO-s, por midis partive kryesore politike kishte diferenca në qëndrime dhe vlerësime lidhur me opsionet e zgjidhjes së krizës në Kosovë si dhe aktet e ndërmarra nga aktorët politikë dhe ushtarakë atje.⁸⁹ Palët politike kishin njohje të ndryshme mbi situatën në Kosovë, kishin prioritete të ndryshme në raportet politike me vendet fqinje dhe synonin të arrinin objektiva paralele të ndryshme edhe nga kriza e luftës.

Së fundi, kriza e viteve 1998-1999 krahas memories historike dhe elementëve ndikues kulturorë, subjektiv dhe njohës, shërbeu edhe si test maturie, reagimi, administrimi dhe mbijetese për strukturat shtetërore e shoqërore. Shteti reagoi me të gjithë kapacitetet e tij, herë në mënyrë eksperimentale dhe kaotike, herë në mënyrë utopiste dhe humanitare. Ai u përpoq të mësonte duke ushtruar qeverisjen dhe administrimin e krizës. Në arkivën shtetërore nuk ka asnjë dokument shterues që analizon në thellësi rolin e shtetit shqiptar në ngjarjet e vitit 1998-1999, dokumente që duheshin hartuar, trajtuar dhe vlerësuar si bazë referimi për mësimet dhe reflektimet për të ardhmen. Gjithsesi ekzistojnë prova se shteti shqiptar, me forcimin e tij rriti edhe kapacitetet e veta dhe përmirësoi ndjeshëm edhe mekanizmat e ndërhyrjes dhe menaxhimit. Kriza të veçuara si ajo më 2004 apo 2023 në Kosovë nxorën në pah një shtet që reagon institucionalisht, bashkëpunon me aleatët strategjikë dhe NATO-n, si dhe vepron duke qenë pjesë e aleancës së sigurisë. Paralelisht strukturat e emergjencave, baza ligjore, përgjegjësitë e shtetit në kriza etj., janë rishikuar dhe përmirësuar gjatë viteve, përfshirë edhe hartimi i dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, i cili për herë të parë

⁸⁹ Afrim Krasniqi (2023). Kosovo and Albania, a special relationship. Retrospectives and Challenges Toward the Future, 55-75, in Lika, L. (Ed.). (2023). Kosovo's Foreign Policy and Bilateral Relations (1st ed.). Routledge, 65.

u miratua në vitin 2000, pra si rrjedhojë e krizës dhe mësimëve të vitit 1999.

Një prej mësimëve nga përvoja e këtyre viteve është sfida e pranimit nga Shqipëria të faktit se nuk mund të ketë rol kujdestar dhe se nuk mund të iniciojë nisma apo të përfaqësojë Kosovën pa konsultime e dakordësi paraprake. Në këto procese raportet institucionale janë më të rëndësishme se ato personale dhe se ndryshimi i qeverive apo natyra ideologjike e tyre nuk përbën motiv kushtëzues. Dy shtetet kanë institucionet e veta përfaqësuese legjitime dhe strategjitë përkatëse, të cilat, në aspektin e konceptit komb, pritet të plotësojnë njëra-tjetrën. Referuar ngjarjeve të vitit 1998-1999 Shqipëria nuk ka ende një databazë të besueshme dhe të referueshme të dhënash, arkiv të pasur me dëshmi, regjistra apo materiale, si dhe as vlerësim zyrtar e dakordësi për gjykimin retrospektiv të ngjarjeve. Më 5 qershor 1999 kryeministri nxori urdhrin nr. 48 *“Për disa masa për grumbullimin e provave dhe dëshmive dhe përgatitjen e procedurave për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë”*, por nga të dhënat arkivore nuk rezulton se qëllimet e urdhrin janë përmbushur dhe se si i tillë, ishte akt më shumë deklarativ sesa funksional.